

E L James

Pesëdhjetë Hije më të Errëta

Roman

Përktheu nga origjinali: M B Bako

Botimet
DRITAN
Tirana

Titulli i origjinalit: Fifty Shades Darker, E L James.

First published by The Writer's Coffee Shop Publishing House,
Australia, 2011

Copyright © 2011, Fifty Shades Ltd.

The author published an earlier serialized version of this story online with different characters as *Master of Universe* under the pseudonym Snowqueen's Icedragon.

© Për Përkthimin: Botimet DRITAN – TIRANË.

ISBN: 978-99956-21-79-7

Redaktoi: Vladimir Bako

Dritan Editions - Tirana
Bulevardi "Bajram Curri", Aviacioni i Ri, 7/51,
Tirana, Albania.
Tel.&Fax: 00355 4 222 40 44
Tel.: 00355 4 224 57 09
E-mail: botimetdritan@gmail.com

Pesëdhjetë Hije më të Errëta

E L. James është ish-producente televizioni, bashkëshorte dhe nënë e dy fëmijëve e banon në Londrën Perëndimore. Qysh në fëmijërinë e hershme, ajo ëndërronte të shkruante histori, me të cilat lexuesit do të binin në dashuri, po këto ëndrra do t'i linte në pritje për t'u përqendruar te familja dhe karriera. Më në fund, mori kurajën të vinte penën mbi letër me romanin e saj të parë “Pesëdhjetë Hijet e Greit”. Ajo është, gjithashtu, autorja e romaneve “Pesëdhjetë Hije më të Errëta” dhe “Pesëdhjetë Hije të Çliruara”.

LIBRA NGA E L JAMES

Pesëdhjetë Hijet e Greit

Pesëdhjetë Hije më të Errëta

Pesëdhjetë Hije të Çliruara

*Për Z dhe J,
Keni dashurinë time të pakushtëzuar, gjithmonë*

FALËNDERIME

U detyrohem një mirënjohje të pakufishme Sarës, Keit dhe Xhadës. Ju faleminderit për gjithçka që keni bërë për mua.

Gjithashtu, falënderime TË PAMATSHME Kethlinës dhe Kristit, që vunë dorë dhe sistemuan materialin.

Faleminderit, po ashtu, Niall, bashkëshorti im, i dashuri im dhe miku im më i ngushtë (pjesën më të madhe të kohës).

Dhe një brohoritje të madhe të gjitha grave të mrekullueshme, të mrekullueshme nga e gjithë bota, të cilat kam pasur kënaqësinë t'i takoj që kur fillova gjithë këtë dhe që tashmë i konsideroj mikeshë, mes tyre: Ale, Aleks, Emi, Andrea, Anxhela, Asusena, Bebs, Bi, Belinda, Betsi, Brendi, Brit, Kerëllajn, Kethrin, Don, Guen, Hana, Xhenet, Jen, Xhen, Xhill, Kethi, Kejti, Kelli, Liz, Mendi, Margaret, Natalia, Nikolë, Nora, Olga, Pem, Polinë, Raina, Raizi, Rajka, Rian, Ruth, Stef, Suzi, Tasha, Tejlër dhe Una. Dhe, gjithashtu, shumë grave (dhe burrave) të ngrohta, të talentuara, të këndshme, që kam takuar onlajn. Ju e dini kush jeni.

Faleminderit Morganit dhe Xhejnit për gjithçka në lidhje me *Hithmenin*.

Dhe, më në fund, faleminderit Zheninë, redaktorja ime. Je e hatashme. Kaq.

Pesëdhjetë
Hije
më të Errëta

PROLOG

Ai është kthyer. Mami është në gjumë ose e sëmurë sërish.

Fshihem dhe kruspullosem nën tryezën e kuzhinës. Përmes gishtave, mund të shoh mamin. Ajo po fle në kanape. Dora e saj ndodhet mbi sixhadenë jeshile ngjitesë, kurse ai ka veshur çizmet e mëdha me tokëzën e shndritshme dhe po çirret mbi mamin.

E godet mamin me rrip. *Ngrihu! Ngrihu! Kurvë e dreqit! Je një kurvë dreqi. Je një kurvë dreqi. Je një kurvë dreqi. Je një kurvë dreqi. Je një kurvë dreqi. Je një kurvë dreqi.*

Mami lëshon një ngashërim. *Mjaft. Mjaft, të lutem.* Mami nuk gërthet. Mami mblidhet një grusht.

Fut gishtat në veshë dhe mbyll sytë. Zhurma ndalon.

Ai kthehet dhe arrij t'i shoh çizmet teksa hyn duke përplasur këmbët në kuzhinë. Ka akoma rripin në dorë. Po orvatet të më gjejë.

Përkulet dhe zgërdhiet. Vjen erë të keqe. Cigaresh dhe alkooli. *Ja ku qenke, mut i vogël.*

Një ulërimë therëse e zgjon. *Krisht! Është bërë qull në djersë dhe zemra i rreh fort. Çfarë dreqin? Brof ndenjuri në shtrat dhe vë kokën ndër duar. Mut. U kthyen prapë. Ishte klithma ime.* Mbushet thellë me frymë për të marrë veten, duke u përpjekur të heqë mendjen nga era e uiskit burbon të lirë dhe e cigareve bajate *Kamel* që ndien në flegra.